

V E N D I M
"Për vendosjen e sekuestros preventive"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga:

GJYQTAR: ANILA KRISTANI

asistuar prej sekretares gjyqësore **Miranda Karakosta**, sot më datë 10.03.2016 ora 11 15, pasi mori në shqyrtim kërkesën që i përket:

Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë,
përfaqësuar nga prokurore z.Suela Salavaci.

Objekti: 1.Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit "A... P..." me nipt L3 ...5V dhe të shtetases A. M. duke urdhëruar Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyrat Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në varësi , për moslejimin e tjetërsimit të pasurive të këtyre subjekteve.
2.Vendosjen e sekuestros preventive mbi aksionet e subjektit "A... P..." me nipt L3 ...5V, dhe të shtetases A. M. për mostjetërsimin e tyre duke urdhëruar QKR-në për moskryerjen e transaksioneve të këtyre subjekteve.
3.Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e luajtshme të subjektit "A... P..." me nipt L3 ...5V dhe të shtetases A. M. sipas listës së aseteve datë 31.12.2014.

Baza ligjore : Nenet 274 /1/2/ të K.Pr.Penale.

Gjykata pasi administroi aktet shkresore, dëgjoi kërkesën e prokurores e cila kërkoi pranimin e kërkesës,

V Ë R E N

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e materialit hetimor të dërguar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qëndror Tiranë, datë 22.04.2015 ka regjistruar procedimin penal me nr.5261 të vitit 2015 për veprën penale të "Fshehje të Ardhurave", "Mospagim të Taksave" dhe "krijimi i skemave mashtruese me TVSH" të parashikuara nga nenet 180, 181 dhe 144/a të Kodit Penal.

Nga hetimet e kryera ndër të tjera dyshohet se subjektet "F...F..." sh.p.k me nipt L2...2G dhe A... P..." sh.p.k me nipt L3 ...5V me aktivitet në fushën e hidrokarbureve, i kanë shkaktuar një dëm të konsiderueshëm administratës tatimore, duke fshehur të ardhurat reale të aktivitetit si dhe duke mos paguar detyrimet e dala gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Skema e përdorur prej tyre dyshohet se ka qënë e ndërtuar me disa subjekte të tjera paraardhëse, dhe momentin kur administrata tatimore ka marë masa administrative ndaj njërit prej subjekteve, asetet e tij kanë kaluar tek subjekti tjetër dhe me rradhe deri tek subjekti "A... P..." sh.p.k i cili në muajin qershor të 2014 u shit tek aksionierë të tjerë, gjithashtu blerja fiktive e aseteve i ka shërbyer subjekteve për të kredituar TVSH-në me qëllimin e mospagimit të detyrimeve tatimore nga shitja e produktit (karburant).

Subjekti “F...F...” sh.p.k me nipt L2...2G, ka filluar ushtrimin e aktivitetit në datën 05/12/2012, me administrator ne periudha te ndryshme z.A. P., Z.E. O.I, I. A., ky subjekt aktivitetin e tij e ka filluar duke blere asetet e subjekti “E...-K” me nipt K7...1C, që në momentin e themelimit ka pasur si administrator të parë z.A. P..

Me datë 07.12.2012 shoqëria “E...-K” ka çrregjistruar gjithsej 21 (njëzete e nje) adresa sekondare, dhe po ne këtë datë (07.12.2012) shoqëria “F...F...” sh.p.k ka rregjistruar të njëjtat adresa sekondare gjithsej 21 (njëzetë e një), keto veprime janë kryer nga te njejtet persona.

Ne vazhdim me date 12.12.2012 shoqëria “E...-K” ka çrregjistruar gjithsej 39 (tridhjet e nënët) adresa sekondare, dhe po ne këtë datë (12.12.2012) shoqëria “F...F...” ka rregjistruar të njëjtat adresa sekondare gjithsej 39 (tridhjet e nënët), keto veprime janë kryer nga te njejtet persona.

Gjitashtu me datë 03.01.2013 shoqëria “E...-K” ka çrregjistruar gjithsej 25 (njëzetë e pesë) adresa sekondare të mjeteve, dhe po ne këtë datë (03.01.2013) shoqëria “F...F...” ka rregjistruar të njëjtat adresa sekondare gjithsej 25(njëzetë e pesë), keto veprime janë kryer nga te njejtet persona.

Në vitin 2013 mbas shitjes së aseteve shoqëria “E...-K” ka ndërprerë deklaratimet, duke mbartur një detyrim tatimore në shumën 284,685,479 lekë, ku pjesa me e madhe e këtij detyrimi në shumën 213,304,182 lekë është nga mospagimi i TVSH-së.

Dyshohet se subjekti “F...” qe ushtron aktivitet nga janari-Dhjetor 2013, deri ne gusht te 2013 ka perfituar nga gjëndja e kreditore e blerjes fiktive të aseteve të shoqëris “E...-K”, duke mos paguar TVSh-në, nga muaj gusht e deri ne dhjetor 2013 ka shpallur për pages ne sistemin tatimor 143,378,545 lekë, ne muajn shtator e ne vazhdim administrata tatimore ka berë njoftimin per pages të kësaj Tvsh-je, ne momentin që filluan te merreshin masat shterngruese nga administrata tatimore rezultoi se subjekti kishte shitur me fatura tatimore pa transaksion bankar asetet e shoqërise “A... P...” ne shumen 150.600.000 lekë, ndërkohe kishte ç’fiskalizur pajisjet fiskale duke mbyllur dhe adresat sekondare.

Po ne të njejtin kohe shoqëria “A... P...” me nipt L3 ...5V, ka filluar aktivitetin më datë 26/09/2013, me administrator Z.F. H., (i cili figuron i rregjitruar në listëpages e subjekteve F... dhe E...-K, si shitës karburanti) ky subjekt aktivitetin e tij e ka filluar duke bjerë asetet e shoqërisë “F...” me nipt L2...2G, në shumën 150.600.000 lekë.

Me datë 31.10.2013, shoqëria “F...” sh.p.k me administratore R. P. dhe me aksionere të vetme shtetasen A. M. ka çrregjistruar gjithsej 55 (pesëdhje e pesë) adresa sekondare, dhe po ne këtë datë (31.10.2013) shoqëria “A... P...” ka rregjistruar të njëjtat adresa sekondare gjithsej 55 (pesëdhje e pesë), keto veprime janë kryer nga një person i vetëm.

Në vazhdim me datë 05.12.2013 shoqëria “F...” sh.p.k ka çrregjistruar gjithsej 26(njëzetë e gjasht) adresa sekondare të mjeteve, dhe po ne këtë datë (05.12.2013) shoqëria “A... P...”sh.p.k ka rregjistruar të njëjtat adresa sekondare te mjeteve gjithsej 26 (njëzetë e gjashtë), keto veprime për te dyja shoqërit janë kryer nga shtetasi A. P., i cili ne atë periudha ishte administrator i subjektit “F...” sh.p.k.

Në janar te vitit 2014 subjekti "F..." sh.p.k ka nderprere aktivitetin e tij duke mbartur një detyrim tatimor ne shumen 553,279,755 lekë, ku pjesa me e madhe e këtij detyrimi në shumën 437,044,201 lekë, nga mos pagimi i TVSh-së.Nga blerja e aseteve te shoqërisë "F..." sh.p.k , shoqëria "A... P..." ka kredituar TVsh-në e cila ka shërbyer bashke me blerjet e tjera që shoqëria prej afro një viti që nga fillimi i aktivitetit të saj te mos paguaj Tvsh-ne.

Me shkresën Nr.11341 prot, datë 17.09.2015, subjekti "A... P..." sh.p.k me nipt L3 ...5V është Njoftuar për Kontrollin Tatimor, që Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Medhenj do ushtronte në këtë subjekt, sipas propozimit të bërë nga Drejtoria e Hetimit Tatimor (Rajoni Qëndror) Tiranë . Në përfundim të Raport-Kontrollit, me shkresën Nr. 11341/9 prot, datë 19.02.2016, është njoftuar nga ana e Drejtorisë Rajonale e Tatimpaguesëve të Medhenj për rezultatin e përfundimit te Raport-Kontrollit, në të cilin detyrimet e subjektit dalin në shifrën e konsideruashme prej shumës 299,528,305 lekë.

Duke parë shifrën e konsiderueshme të detyrimit, dhe individët të cilët kanë qënë administratore dhe aksionierë në këto shoqëri, të cilët janë dhe personat në hetim dhe për të parandaluar përsëritjen e skemës së tjetërsimit të aseteve, janë kryer verifikime si në sistemin e QKR-së nga ku ka rezultuar se pranë saj janë kryer disa veprime dhe konkretisht:

-Më datë 27.01.2016 subjekti "A... P..."sh.pk ka aplikuar në QKR për mbylljen e disa nipteve sekondare, duke bërë dhe c' regjistrimin e kasave fiskale, dhe po në të njëjtën datë subjekti "D... O..."sh.p.k, me nipt L5...0GL5...0G, ka aplikuar për hapjen e këtyreve adresave sekondare, po me datë 09.02.2016 dhe 24.02.2016 ka pasur të njejtat lëvizje, figuron që për keto ndryshime ne Q.K.R, janë autorizuar persona të cilët kan bërë veprime si për njërin subject dhe tjetërin,

-Më datë 24.02.2016 rezultojnë të çregjistruara 21 nipte sekondare nga subjekti "A... P..."sh.p.k dhe po aq të regjistruara tek subjekti "D... O..." sh.p.k , me nipt L5...0GL5...0G.

Gjithashtu nga kqyerja e sistemit tatimor C@TS (costoms and taxation system), përkatësisht në rubrikën e lisëtpagesat e subjektit E..., rezulton se punonjësit e deklaruar nga subjekti "A... P..." janë larguar me datë 26.02.2016, dhe po në këtë datë subjekti tjetër "D... O...", me nipt L5...0G, i ka shtuar si punonjës së saj.

Më datë 01.03.2016 rezultojnë të çregjistruara 99 punonjës nga subjekti "A... P..."sh.p.k dhe po aq të regjistruara tek subjekti "D... O...", me nipt L5...0G.

Me anë të ID personale është evidentuar në sistemin tatimor C@TS, të dhëna për të shtetasin H. B., administrator dhe aksionieri i vetëm i shoqërisë "D... O...", me nipt L5...0G, ku ka rezultuar se shtetasi H. B. është i punësuar si "shofer" nga Janari 2012 deri në janar 2016 në shoqërinë "S...I" sh.p.k me nipt J6...7H, me aktivitet tregëtar "Tregetia me pakice ne dyqane jo te specializuara, me mbizoterim artikujsh ushqimore, pije e duhan".

Me shkresën Nr ... prot, date 01.03.2016, Sektori i Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor (Rajoni Qëndror) Tiranë, ka përcjellë Akt-Konstatimet e mbajtura në 3 pika karburanti, ku kanë ndodhur lëvizjet e sipërcituara.

Në analizën e bërë gjatë kontrollit në këto pika karburanti na rezulton se, subjekti "D... O...", me nipt L5...0G, i cili ushtron aktivitet në pikat e karburantit ku më parë ushtronte aktivitet subjekti "A... P...", kanë të njëjtin "LOGO", të njëjtët punonjës.

Për sa më sipër me kërkesën drejtuar gjykatës nga ana e organit të prokurorisë është pretenduar se bazuar në faktet dhe provat e grumbulluar kanë dyshime se po përdoret e njëjta skemë për tjetërsimin e aseteve, si në rastet e përshkuara më sipër. Tjetërsimi i

pasurisë së subjektit “A... P...” sh.p.k , do të bënte të pamundur pagimin e detyrimeve tatimore të këtij subjekti duke dëmtuar interes e shtetit dhe në këto kushte kanë kërkuar nga gjykata vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit “A... P...” me nipt L3 ...5V dhe të shtetases A. M. duke urdhëruar Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyrat Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në varësi , për moslejimin e tjetërsimit të pasurive të këtij subjekti, si dhe vendosjen e sekuestros preventive mbi aksionet e subjektit “A... P...” me nipt L3 ...5V, dhe të shtetases A. M. për mostjetërsimin e tyre duke urdhëruar QKR-në për moskryerjen e transaksioneve të këtij subjekti, si dhe vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e luajtshme të subjektit “A... P...” me nipt L3 ...5V dhe të shtetases A. M. sipas listës së aseteve datë 31.12.2014.

1.Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprimeve penale të tjera , me kërkesën e prokurorit ,gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2.Sekuestroja mund të vendoset edhe për sende produktet e veprës penale dhe cdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas neneit 36 të Kodit Penal”, duke vlerësuar se disponimi i lirë i pasurive të paluajtshme të subjektit “A... P...” sh.p.k me nipt L3 ...5V dhe të shtetases z.A. M. , si dhe i kapitalit mbi subjektin “A... P...” sh.p.k me nipt L3 ...5V , si dhe mbi pasuritë e luajtshme të subjektit “A... P...” sh.p.k me nipt L3 ...5V sipas listës së aseteve të datës 32.12.2014 (listë emërore nga numeri 1 deri 325, shtate fletë) dhe të shtetases z.A. M. mund të rëndojë apo të zgjasë pasojat e veprave penale që dyshohet se janë konsumuar në këtë procedim penal ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera , cmon të pranojë kërkesën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në në nenin 274 pikat 1dhe 2 të K.Pr.Penale;

V E N D O S I

1- Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit “A... P...” sh.p.k me nipt L3 ...5V dhe të shtetases z.A. M. duke urdhëruar Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyrat Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në varësi , për moslejimin e tjetërsimit të pasurive të këtyre subjekteve.

2- Vendosjen e sekuestros preventive mbi kapitalin e subjektit “A... P...” sh.p.k me nipt L3 ...5V, dhe të shtetases z.A. M. për mostjetërsimin e tyre duke urdhëruar QKR-në për moskryerjen e transaksioneve të këtyre subjekteve.

3- Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e luajtshme të subjektit “A... P...” sh.p.k me nipt L3 ...5V dhe të shtetases z.A. M. sipas listës së aseteve datë 31.12.2014 (liste emerore shtate flete artikuj nga numeri 1-325).

Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tiranë sot më datë 10.03.2016.

SEKRETARE
MIRANDA KARAKOSTA

GJYQTARE
ANILA KRISTANI

